



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2017/06

Bazuar në nenin 3, paragrafi 2.5 dhe 2.6 dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton:

RREGULLORE PËR TARIFËN VJETORE PËR LICENCË

NENI 1 QËLLIMI

1. Përcaktimi i nivelit të tarifës për aplikim për licencë të KPM-së për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së.
2. Përcaktimi i nivelit dhe mënyrës së pagesës së tarifës vjetore për licencë për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së.
3. Përcaktimi i nivelit të tarifës në lidhje me ndryshimin apo vazhdimin e licencës së KPM-së për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së.

NENI 2 TARIFA PËR APLIKIM PËR LICENCË

Parashtruesi i kërkesës me rastin e dorëzimit të aplikacionit për licencë për OSHMA dhe operator të shpërndarjes duhet ta paguajë një tarifë administrative në shumën e pakthyeshme prej njëqind Euro (100 €) në llogarinë bankare të KPM-së.

NENI 3 KATEGORIZIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO (radio) ME TRANSMETIM TOKËSOR ANALOG

1. **Kategoria e radiove me mbulim nacional** - i përket Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio, të cilat mbulojnë me sinjal radio, përmes frekuencave, të paktën 95% të territorit të Republikës së Kosovës.
2. **Kategoria e radiove me mbulim regjional** – i përket Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio, të cilat mbulojnë me sinjal radio, përmes një frekuence, nga 30% deri në 60% të territorit të Republikës së Kosovës.

